



Thirrje për shprehje interesi

KB Krusha është një kompani kosovare që kryesisht merret me përpunimin e perimeve, duke punësuar kryesisht gratë nga rajoni i Krushës. Kompania aktualisht ka 29 produkte të etiketuara me markën "KB Krusha" dhe ka bashkëpunim të mirë me fermerët e zonës. Produkti përfundimtar eksportohet dhe shitet në tregun vendor nëpër supermarkete, dyqane ushqimore, por edhe direkt nga njësia përpunuese.

KB Krusha Sh.P.K shpall njoftimin si në vijim:

Propozim për implementimin dhe certifikimin ne standarde ISO 22000 perfshtier HACCP

KB Krusha Sh.P.K ka fituar grantin nga Komisioni Europian për Investim ne objektin perpunues ne menyre qe te permbushen standarde e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit. Prandaj, si pjesë e këtij investimi do të bëhet implementimi i standardeve mbi sigurinë dhe cilësinë e ushqimit dhe certifikimi ne HACCP. Me këto standarde kompania synon krijimin e një kulture të përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve, përmirësimin e angazhimit të punonjësve drejt përmirësimit të procesit, si edhe zvogëlimin e koston përmes përmirësimit të vazhduesh që arrihet me menaxhimin e sistemit te cilesise dhe sigurisë ushqimore në ISO22000.

Standardet e sigurisë dhe cilësisë ne ushqim ISO 22000 + HACCP do të sigurojnë qe kompania eshte ne rruge te drejte te përmbushjes se elementeve si ne vijim:

- Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë ushqimore;
- Përmirësimi i imazhit të kompanisë në treg dhe rritja e besimit tek konsumatorët përmes certifikimit me ISO22000 me HACCP të integruar;
- Përmirësimi i kënaqshmërisë së konsumatorit duke përmbushur kërkesat e tyre
- Përmirësimi i proceseve të brendshme dhe integrimi i tyre në tërësi;
- Përmirësimi i vendimmarrjes duke u bazuar në të dhënat dhe dokumentimin e rregullt të sistemit të menaxhimit.

Shprehja e interesit duhet të përfshijë specifikime të hollësishme rreth:

- Kohëzgjatjen e shërbimit dhe strukture se implementimit
- Detajet rreth përgatitjes se dokumentacionit, perfshtier:
 - o Kërkesat e përgjithshme të ISO22000 dhe dokumentet përkatëse
 - o Përkufizimi i dokumenteve të dorëzuara për proceset e realizimit të produktit
 - o Dokumente të dorëzuara për proceset e matjes, analizës dhe përmirësimit
- Koston e Implementimit dhe Certifikimit

KUSHTET KRYESORE TË OFERTËS

- 1) Propozim të plotë rreth kontekstit procesit të realizimit;
- 2) Plani i zbatimit (duke pasur në konsideratë kohëzgjatjen prej rreth 10 javë pune)
- 3) buxhet i hollësishëm me njësi të ndarë në pagesë ditore në bazë të angazhimit ne implementim dhe kostoja e certifikimit.

Oferta me çmim ekonomikisht më të favorshëm do të jetë objekt i përzgjedhjes.

Ju lutemi vini re se oferta e shprehjes së interesit duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe angleze.

KËRKESA PËR KUALIFIKIM

Konsulenti pritët të sigurojë ndihmë teknike dhe ekspertizë për implementimin e standardeve te cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Për t'u kualifikuar konsulenti i interesuar kërkohet të plotësojë kushtet si në vijim:

- Të jetë entitet i regjistruar dhe të deklarojë atë si në formularin e aplikantit
- Të ketë përvojë në menagjimin e projekteve, me specifika ne implementim te standardeve te cilësisë dhe sigurisë ushqimore.
- Të ketë diplomë univerzitare, MSc do të jetë avatazh
- Të ketë përvojë në implementim te standardeve te cilësisë dhe sigurisë ushqimore jo më pak se 5 vjet.
- Te ofroje dokument / marrëveshje bashkëpunimi me nje entitet te certifikuar ndërkombëtarisht

Aplikimet duhet të dorëzohen jo më vonë se ora 16:00. më 30 Mars 2021. Aplikimet do të dorëzohen në format elektronik (në një dokument PDF) në: kb1_krusha@hotmail.com me titull "Oferta për implementim dhe certifikim ne ISO 22000 me HACCP te integruar, nr. 2019/413-429" Aplikimet e vonuara ose të paplota nuk do të konsiderohen.

Konsulentët e përzgjedhur do të ftohen për negociim më së largu me date 1 Prill 2021.